Kronikë

VIDEO+EMRI / I maskuar dhe i armatosur, hyri në një market dhe kanosi me armë shitësin për t'i marrë paratë! Arrestohet në flagrancë 20-vjeçari në Durrës

I maskuar për të mos u identifikuar nga kamerat e sigurisë dhe i armatosur për të kanosur shitësin e dyqanit, një grabitës 20-vjeçar hyri mbrëmë gjatë natës, në një market në Durrës, me qëllim vjedhjen e parave në kasë.

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
11 Gusht, 10:22 | **Përditesimi: 11 Gusht, 13:45**

I maskuar për të mos u identifikuar nga kamerat e sigurisë dhe i armatosur për të kanosur shitësin e dyqanit, një grabitës 20-vjeçar hyri mbrëmë gjatë natës, në një market në Durrës, me qëllim vjedhjen e parave në kasë.

Grabitësi i identifikuar, Kristjan Prenga, u arrestua në flagrancë brenda marketit, ku tentoi të vidhte paratë.

LEXO EDHE:
VIDEOLAJM/ 15 pilotë nga gjithë bota garojnë në Sarisalltik, Rama: Provë force e turizmit shqiptar

Ngjarja ka ndodhur rreth orës 21:50 të mbrëmjes së djeshme, në një market në lagjen nr.13 në Durrës, gjatë kohës që shitësi ishte ende në shërbim.

Video e siguruar nga shërbimet e policisë, tregon momentin kur Kristjan Prenga, me armë në dorë fuetet në market dhe i drejtohet shitësit duke i kërkuar që t'i nxjerrë paratë nga kasa.

Sakaq, me të marrë njoftimin për grabitjen policia ka mbërritu në vendngjarje dhe ka bërë të mundur arrestimin në flagrancë të 20-vjeçarit, i cili nuk kishte kryer ende vjedhjen.

Mësohet se i riu banontë në po të njejtën lagje ku ndodhej edhe marketi, të cilin tentoi të grabiste.

Në cilësinë e provës materiale u sekuestrua arma e zjarrit pistoletë, me të cilën kanosi 20-vjeçari, për të kryer vjedhjen.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë Durrës, për veprime të mëtejshme.

M.T/Shqiptarja.com

TAG: Durres grabitje arme kristjan prenga

Komente

Xxxxx: 11/08/2023 10:53

Eh maloket...

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Siguria në plazhe krahasuar me një vit më parë është:

Më mirë | Më keq | Njësoj

Lajme të tjera

Ekstazi me logon e 'Louis Vuitton', sekuestrohen mbi 11 mijë tableta me vlerë 400 mijë euro në Tiranë! Droga vinte nga Kosova! Mes 5 të arrestuarve edhe zyrtari i LVV-së
15 Gusht, 09:53



VIDEO/ Iu gjetën 11 kg kanabis në proces tharje pranë banesës, në pranga babë e bir në Krujë
14 Gusht, 11:49



Mbetën në mes të detit pasi skafet pësuan defekt, policia shpëton 12 pushues në Velipojë dhe Durrës
14 Gusht, 11:18

I dogji 'Ferrarin' e Noizyt, zbardhet dëshmia e autorit, Siar Konti: Më pagoi 6 mijë euro Cllevio Serbiano
13 Gusht, 11:04

Tentoi të fuste 100,460 paund në Shqipëri përmes Portit të Durrësit! Arrestohet 30-vjeçari, vinte nga Anglia
12 Gusht, 10:21

U vodh në Durrës, gjendet makina në fshatin Gjormë të Lezhës! Shoferi braktis mjetin
11 Gusht, 15:58

I vunë flakën një makine 5 ditë më parë, arrestohen në Durrës dy të rinj nga Vlora
11 Gusht, 14:58

U kapën në Durrës me 121 mijë euro të fshehura në tavanin e autobusit që vinte nga Bari! Gjykata lë në burg Leonard Nikollin, nën hetim shoferi
11 Gusht, 11:40

U gjet i pajetë në breg të detit në Durrës, 39-vjeçari dyshohet të ketë vdekur për shkaqe natyrale
11 Gusht, 09:39



Jahti dha alarmin SOS, kishte lundruar nga Tivari i Malit të Zi, drejt Durrësit! I shkon në ndihmë kapiteneria e portit
11 Gusht, 00:12

Fushë Krujë/ Banorët e Borizanës: Shpërthime të fuqishme nga guroret, po na dëmtohen banesat! Mbërrin policia
10 Gusht, 21:12

Durrës, aggjencinë private të sigurimeve e kthyen në dyqan për të shitur kokainë e kanabis
10 Gusht, 12:37

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje